

VENDIM
Nr.1677, datë 24.12.2008

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I STACIONIT TË
POMPIMIT, TUSHEMISHT, POGRADEC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i stacionit të pompimit, Tushemisht, Pogradec.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a.-së Pogradec.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 100 (njëqind) m², me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 62 490 (gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 221 000 (dyqind e njëzet e një mijë) lekë, të përballohen nga ujësjellës-kanalizime, sh.a. Pogradec.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 62 490 (gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
 6. Shpronësimi të fillojë më 25.12.2008 dhe të përfundojë më 30.1.2009.
 7. Pronari të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., Pogradec.
 8. Ujësjellës-kanalizime, sh.a. Pogradec, të kryejë verifikimet për përputhshmërinë e sipërfaqes, që preket me numrin e pasurisë në pronësi të pronarit, që shpronësohet.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe ujësjellës-kanalizime, sh.a. Pogradec, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
STACIONIT TË POMPIMIT, TUSHEMISHT, POGRADEC**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kad.	Nr.pas	Lloji pas.	Sip m2	Çmimi m2/lekë	Vlera (lekë)
1	Hil	Ndoc	Hila	3664	4/8	Tokë arë	100	624.9	62 490